

Pershendetje z.H.....

Ne lidhje me pyetjet tuaja, ju bejme me dije se:

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave bazuar ne Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 119 deri 160 dhe 169 deri 181, dhe VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 233 deri 329 dhe 349 deri 363 vepron mbi bazen e formaliteteve mbi mallrat që hyjnë ose dalin nga **territori doganor** i Republikës së Shqipërisë pranë autoriteteve doganore për të kryer procedurat sipas **njëres nga mënyrat e deklarimit**, te pershkruara nga legjislacioni i siperpermendur. Ne rastin konkret, ku ju I referoheni anijes Queen Majeda, ju bejme me dije se prane autoriteteve doganore nuk eshte paraqitur nje deklarate doganore, e cila do te permbante te dhenat qe kerkohen nga ana juaj ne lidhje me agjensine doganore qe do te mbulonte procedurat, kompanine porositese/pritese dhe sasine e mallit.

Gjithashtu, nga analizimi i komponenteve clirim per qarkullim te lire - hedhje ne treg, ne sistemin tone, nuk rezultojne te jene kryer veprime nga/ose ky mjet ransporti.

Në 12 shtator 2022, ndaj anijes “Queen Majeda”, e cila transportonte ngarkesë me naftë me origjinë nga Libia, u ndermor nje operacion policor, jashte territorit doganor, dhe eshte hapur nje procedim perkates penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor qe ka bere ndalimin dhe referimin e rastin ne gjykate me prezumimet perkatese. Si i tille, informacioni qe ju kerkoni eshte jashte kompetencave te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe ju duhet ti drejtoheni institucioneve te tjera ligjzbatuese qe jane marre me rastin qe ju trajtoni.

Praktikat midis organeve te Policise dhe/ose Prokurorise me DP Doganave jane te percaktuara ne baze te Marrveshjeve perkatese te cilat rishikohen sipas nje kalendari te percaktuar kohor (marrveshja e fundit eshte e dates 17/04/2022). Nga teresia e akteve legislative, theksojme, se ne rastin e kundravajtjeve (ndermjet tyre edhe kontrabandes), prevalon zbatimi i Kodit Penal dhe i Kodit te Procedurave Penale ndaj Kodit Doganor dhe Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor. Si e tille, edhe kompetenca vendim-marrese institucionale e organeve të permendura me siper ndjek shkallen hierarkike vertikale.

Bazuar ne Rezolutat Perkatese te OKB, (duhen kuptuar rastet kur vendoset embargo) Korporata Kombetare e Naftes ne Libi (NOC) eshte autoriteti i vetem, i njohur nderkombetarisht, i cili ka te drejten e leshimit te nje autorizimi per eksportin e naftes. Cdo dokument tjeter konsiderohet i pavlefshem dhe ndaj mallrave vendoset embargo.

Duke ju falenderuar per mirkuptimin